




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	157/15
Nr. i fq. / Br. st	- 11 -
Data: / Datum	30. 07. 2015
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -VI-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,**  
**MBAJTUR MË 25 QERSHOR 2015**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën **10:10**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:  
Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Hysni Gërguri, Habibe Gërxhaliu, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** –paraqiti shqetësimin e tij lidhur me proceset gjyqësore ndaj pjesëtarëve të UÇK-së, duke shtuar se protagonistet kryesor të luftës për çlirim po dënohen në mënyrë të padrejtë dhe bashkë me këtë po njolloset lufta jonë çlirimtare. Pastaj ai në emrin e tij si kryesues i kuvendit dënoj sulmin ndaj kryetarit të komunës z. Bajram Mulaku dhe kërkoi nga organet e drejtësie që autori i kësaj vepre të marr dënimin e meritum.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit** –në emër të grupit kuvendar të PDK-së reagoi ndaj sulmit kundër kryetarit të komunës, duke e cilësuar atë si akt të ultë dhe qyqarë. Tutja ajo në këtë kontekst njoftoi kuvendin se grupi kuvendar i ka dhënë dhe do ti jap mbështetje të plot kryetarit, sidomos pas krijimit të këtyre rrethanave. Në fund ajo tha se në shenjë solidarizimi me kryetarin Mulaku, grupi kuvendar i PDK-së do të marrë pjesë në seancë po nuk do të diskutoj për asnjë pikë të rendit të ditës.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** – në emër të grupit kuvendar të LDK-së, reagoi fuqishëm kundër sulmit drejtuar kryetarit të komunës Bjaram Mulaku dhe familjes së tij, duke e cilësuar si sulm ndaj institucionit të komunës ndaj administratës së saj dhe popullatës që jeton në komunën tonë. Ajo në emër të grupit kuvendar, e dënoj ashpër këtë sulm dhe bëri thirrje që të krijohen kushte për punë në mënyrë të lirshme në një mjedis të sigurt, sepse siç vlerësoi ajo

siguria është parakusht themelor që të bëhen punët si duhet. Në fund ceku se shpreson se ky sulm do të jetë sulmi i fundit në komunën tonë.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** – shprehu keqardhjen e tij lidhur me sulmin drejtuar kundër kryetarit të komunës, dhe shtoi se ky akt nuk i bën mirë askujt. Tutje shtoi se këtij rasti nuk duhet dhënë konotacion të madh për faktin se kryetarin Mulaku dhe punën e tij të mirë e njohin të gjithë. Pastaj ai vlerësoi se ky sulm nuk mund ta denigrojë integritetin e lartë moral të kryetarit të komunës z. Bajram Mulaku. Në fund ai tha se e dënon sulmin në fjalë dhe kërkon që kjo çështje të zgjidhet sa më parë.

**Ermal Lahu, anëtar i kuvendit** – në emër të grupit kuvendar PD-AKR, e dënoi sulmin ndaj kryetarit të komunës, duke shpresuar që nipërit e kryetarit dhe gjeneratat e reja të mos shohin kështu lloj aktesh qyqare.

**Sabri Ferati, anëtar i kuvendit** – kërkoi që çështja e sulmit ndaj kryetarit të komunës të mos politizohet për faktin se kjo çështje është personale të cilën më së miri e din vetë kryetari i komunës. Në fund ai tha se kryetari i komunës i ka meritat e tij, porse edhe familja Mërrnica ka dhënë kontribut të çmuar për çështjen kombëtare, andaj kërkoi që në këtë rast të merren organet e drejtësisë.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit** – në emër të komunitetit turk e dënoi rastin e sulmit ndaj kryetarit Mulaku, duke e cilësuar si rast tragjik dhe i cili nuk e tangon vetëm kryetarin e komunës, por të gjithë qytetarët e Vushtrrisë. Në fund ai shprehu keqardhjen e tij dhe apeloi te organet e drejtësisë që ta thonë fjalën e tyre lidhur me këtë rast.

**Shaban Beka, anëtar i kuvendit** – në emër LB-së dega në Vushtri e dënoi rastin e sulmit ndaj kryetarit të komunës dhe kërkoi nga organet e drejtësisë që ta bëjnë punën e tyre. Gjithashtu ai apeloi që të çmohet kontributi i familjeve që kanë dhënë shumë për çështjen kombëtare dhe të respektohet dinjiteti i pjesëtarëve të UÇK-së.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** – në emrin e tij e dënoi sulmin ndaj kryetarit të komunës, dhe ceku se ka respekt ndaj profesorit Bajram Mulaku. Tutje ai shtoi se personi i cili është protagonist i këtij sulmi është një intelektual i cili ka zgjedhur një formë jonjerëzore për zgjidhjen e problemeve, andaj në këtë kontekst vlerësoi se kjo tregon më së miri që shoqëria jonë është lodhur nga gjendja e rëndë dhe e paperspektivë.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – kërkoi nga kuvendi që në rend të ditës të futet kërkesa e banorëve të fshatrave Lumadh dhe Stanoc i Epërm lidhur me ndërtimin e trasesë së rrugës Vushtri-Prishtinë, pasi një kërkesë e tillë ka mbetur të diskutohet edhe nga mbledhja e kaluar e kuvendit, me arsyen që të përgatitet materiali i nevojshëm lidhur me këtë çështje, si dhe të kërkohet informatë nga ministra përkatëse se përse është ndryshuar ky projekt. Në fund tha se duke e ditur se kjo çështje hyn në domenin e kompetencave të nivelit qendror, kjo nuk i liron nga obligimi autoritetet komunale që të merren me kërkesat e qytetarëve të komunës sonë.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga kuvendi që pika e shtatë që ka të bëjë me informatën lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë, të hiqet nga rendi i ditës për faktin se një informatë e tillë është e mangët ngase ne për çdo ditë jemi dëshmitarë të ndërtimeve pa leje dhe me leje, të raportohet në vetëm një faqe raport në mënyrë kaq sipërfaqësore nuk është aspak serioze. Andaj nga të lartcekurat kërkoi që lidhur me këtë çështje të hartohet një raport më i detajuar ku do të përfshiheshin këto çështje: kujt i janë lëshuar 29 leje ndërtimore, kundër kujt dhe përse janë ngritur 18 fletëparaqitje për kundërvajtje në Gjykatën Themelore të Mitrovicës nga ana e inspektoratit, pastaj cilat janë ato 8 objektet e rrënuara në komunën tonë dhe përse paraqesin rrezik për qytetarët tanë. Në fund ai tha se nëse nuk hiqet nga rendi i ditës kjo pikë, grupi i tyre kuvendar do të votojë kundër rendit të ditës.

**Selvete Sholla, anëtare e kuvendit** – pyeti kryesuesin e kuvendit se përse nuk po respektohet Plani i punës së kuvendit, për faktin se për çdo mbledhje të kuvendit mungojnë minimum 3 pika të rendit të ditës të parapara me Plan të punës. Andaj lidhur me këtë çështje ajo vlerësoi se nga ana e kryesuesit të kuvendit asnjëherë nuk kemi pasur referim dhe një arsye bindëse se përse këto pika nuk po procedohen në kuvend për shqyrtim.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – njoftoi se i ka shprehur keqardhje kryetarit të komunës lidhur me sulmin e orientuar kundër tij. Tutje vlerësoi se ne duhet ta kuptojmë këtë proces vetëm nën petkun e zbardhjes së këtij rasti nga ana e organeve të drejtësisë pa ndërhyrje. Pastaj duke iu referuar këtij rasti ceku se me këtë çështje duhet të merren organet kompetente, dhe se komuna si institucion nuk duhet të përdor “arsenal” tjetër që posedon siç është faqja zyrtare dhe format tjera duke i dhënë konotacion dhe kualifikime për çështje tjera, po të merremi me rastin konkret. Mandej ai vlerësoi se kryetari Mulaku e ka fuqinë intelektuale dhe njerëzore, por edhe ajo familje e cila ka sakrifikuar shumë për çështjen kombëtare që ta tejkalojë këtë situatë. Në këtë kontekst ai gjykoj se nuk duhet të kemi përgjithësime por të merret në përgjegjësi individi që është kryesues i këtij veprimi, andaj si përfundim i krejt kësaj duhet që kjo çështje të marrë epilogun gjyqësor dhe të njëjtës mos t’i jepet konotacion politik. Në vazhdim ai duke iu referuar debatit lidhur me rendin e ditës ceku se edhe nga procesverbali i mbledhjes së kaluar del përfundimi se kuvendi kishte vlerësuar që për këtë mbledhje do të sjell materialin (informatën) lidhur me trasenë e rrugës Vushtri-Prishtinë, përkatësisht do të debatonte lidhur me ankesat e fshatrave Lumadh dhe Stanoc i Epërm që ka të bëjë me këtë çështje, andaj lidhur me këtë kërkoi që kjo çështje të shtrohet për diskutim dhe të merremi më seriozisht qoftë ne si kuvend apo edhe ekzekutivi. Në vazhdim ai ripërsëriti shqetësimin e tij lidhur me fabrikën “Llamkos” konkretisht me çështjen e sigurisë së kësaj fabrike dhe apeloj tek instancat komunale që këtë çështje ta referojnë në AKP. Një tjetër segment të cilin ai vlerësoi që kuvendi ka për obligim të merret është çështja e 18 punëtorëve të mirëmbajtjes në objektet e shkollave të mesme të komunës. Këta punëtorë, të cilët punojnë për kompani të ndryshme ankohen se po iu shkelen të drejtat për faktin se nuk janë të barabartë me punëtorë tjerë të shkollave fillore. Andaj në përfundim të krejt kësaj apeloj për një angazhim të përgjithshëm si të kryetarit, kuvendit dhe DKA-së që të ndikojnë tek punëdhënësi i tyre për respektimin e këtyre të drejtave.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – paraqiti sqarime lidhur me çështjen e trasesë së rrugës dhe ankesat e fshatrave Lumadh dhe Stanoc i Poshtëm dhe tha se kjo çështje është trajtuar nga ana e kuvendit dhe e njëjta është adresuar në ministrinë përkatëse, andaj në këtë moment nuk kemi nevojë që kjo çështje të futet në rend dite për diskutim.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – duke iu referuar një takimi me ministrin Zharku me banorët e fshatit Stanoc të Epërm ceku se ai i kishte sugjeruar që autoritetet komunale duhet të bëjnë pastrimin e pronave të cilat janë të uzurpuara, kurse ata janë të gatshëm ta rregullojnë atë pronë d.m.th rrugën (stacionin e autobusëve dhe nënkalinin), andaj kërkoi nga kuvendi që kjo çështje të futet për shqyrtim dhe diskutim, dhe në të njëjtën kohë propozoi që të formohet një komision miks për adresimin e këtij problemi.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 29 vota “për” 3 “kundër” aprovoi këtë:**

## REND DITE

- 1.Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së e datës 28.05.2015.
- 2.Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së e datës 04.06.2015.
- 3.Shqyrtimi i Raportit të Punës për vitin afarist 2014 të KRM “Uniteti” SH.A Mitrovicë.
- 4.Shqyrtimi i Raportit vjetor të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi Mitrovica SH.A..
- 5.Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2016-2018.
- 6.Shqyrtimi i Informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.
- 7.Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë.
- 8.Të ndryshme.
- 8.a). Shqyrtimi i kërkesës së fshatrave Lumadh dhe Stanoc i Epërm lidhur me trasenë e rrugës Vushtri-Prishtinë.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së e datës 28.05.2015

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e datës 28.05.2015 të KK-së.*

2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së e datës 04.06.2015.

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së e datës 04.06.2015.*

3. Shqyrtimi i Raportit të Punës për vitin afarist 2014 të KRM “Uniteti” SH.A Mitrovicë.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** - tha se kur flasim për Raportin e punës së Kompanisë Regjionale për Mbeturina “Uniteti”, në fillim të tij flitet për konceptin e strategjisë së zhvillimit, për objektivat, për të arritura të kësaj kompanie, ndërkohë që gjendja e menaxhimit të mbeturinave në komunën tonë vazhdon të mbetet e mjerueshme. Në këtë raport nuk vërejmë asnjë ndryshim nga raportet paraprake të kësaj kompanie. E nëse i shikojmë të arriturat dhe menaxhimin e mbeturinave në komunën tonë në të kaluarën, kjo lë hapësirë për të dyshuar se edhe këtë vit do të vazhdohet me avazin e vjetër të funksionimit të kësaj kompanie. Andaj ai vlerësoi se kjo kompani ka dështuar totalisht në menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë. Në vazhdim ai ceku disa nga dështimet e kësaj kompanie në komunën tonë:

1. Menaxhimi i dobët i kontejnerëve të mbeturinave që janë të vendosura në qytet.
2. Lejimi i krijimit të minideponive të mbeturinave nëpër qytet, për shkak të mosvendosjes së kontejnerëve në ato vende.

Shembull: Minideponia e mbeturinave te Kalaja e qytetit në shesh,

3. Krijimi i deponive të mëdha nëpër periferi të qytetit dhe fshatra, si pasojë e mosmbulueshmërisë së atyre vendeve nga kompania në fjalë.

4. Mosefikasiteti në inkasimin e mjeteve financiare nga qytetarët për shërbimet e kryera. Një prej arsyeve për mos inkasim efikas është që kompania e bën inkasimin me paragon blloka, metodë kjo e cila lë hapësirë për dyshime për keqpërdorime tek qytetarët. Pastaj ai shprehu shqetësimin e tij për punëtorët e kësaj kompanie, të cilët edhe pse të ardhurat i kanë minimale për punën që kryejnë, tash e disa muaj nuk i kanë marrë as ato paga minimale. Kjo gjendje ua rrit këtyre punëtorëve varfërinë, i demoralizon në punë dhe ndikon drejtpërdrejtë në menaxhim të mbeturinave në komunën tonë. Në këtë kontekst ai kërkoi nga kompania “Uniteti”, që të ndal politikën diskriminuese ndaj qytetit tonë, të punojë edhe për interesa të qytetarëve e jo vetëm për interesa të tyre personale, të zgjerojë mbulueshmërinë me kontejnerë dhe kapacitete përcjellëse në tërë territorin e Vushtrrisë, pra të përfshihen edhe fshatrat. Po ashtu kërkoi që urgjentisht të bëhen pagesat e punëtorëve për të gjithë muajt që kjo kompani ua ka borxh atyre. Lidhur me çështjet e sipërcekura kërkoi që vërejtjet e dhëna më lartë të evidentohen dhe të eliminohen nga kjo kompani. Në fund ai tha nëse nuk ka përmirësime dhe vazhdohet me avazin e vjetër të trajtimit të mbeturinave, ne kërkujmë nga komuna të gjejë mundësi tjera alternative të zgjidhjes së kësaj çështjeje, duke kontraktuar kompani tjera të cilat do të merren më seriozisht me menaxhimin e mbeturinave, sepse siç duket monopoli i krijuar nga kompania “Uniteti” në komunën tonë ka bërë që këta të mos jenë në nivel të detyrës.

**Agron Perçuku, anëtar i kuvendit** – duke pas parasysh rrethanat në të cilat gjendet qyteti dhe duke parë për së afërmi rrugët në qytet, komuna dhe kompania “Uniteti” kanë dështuar në vetëdijesimin e popullatës, për rendësinë e taksës për mbeturina (pra organizimin e fushatave vetëdijesuese). Mungesa e hartimit të projekt-propozimeve nga OJQ-të e ndryshme që kanë për qëllim menaxhimin e mbeturinave dhe të njëjtat të konkurrojnë për financim (grante) në organizatat e huaja. Tutja ai vlerësoi se Komuna e Vushtrrisë dhe kompania “Uniteti” kanë

dështuar në ndërtimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare sidomos me "GIZ" (organizatë Gjermane) e cila në komunat si Prishtina, Malisheva, Drenasi etj, është duke suportuar teknikisht kompanitë të cilat i mbledhin mbeturinat në këto komuna. Pastaj ai duke ju referuar informatës ceku se injorimi ishte bërë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në mandatin e kaluar. Në vazhdim ai shfaqti si shumë të nevojshme që Kuvendi Komunal i Vushtrrisë të hartojë një rregullore si pjesë e planit për veprim në mjedis, e cila do të obligonte komunën, kompaninë "Uniteti" dhe qytetarët për menaxhim më të mirë të mbeturinave. Te raporti i shërbimit me konsumatorë në lidhje me vetëdijesimin për ngritjen e inkasimit ku thuhet se po që se nuk bëhet pagesa do të ndërpritet shërbimi, sipas gjendjes në terren qytetarët të cilëve ju ndërpritet shërbimi ata i grumbullojnë mbeturinat dhe në një kohë të caktuar i hedhin në pjesë të ndryshme të qytetit, por edhe në pjesët më të afërta ku gjenden kontejnerët të cilët janë të pamjaftueshëm për qytetin e Vushtrrisë. Qytetarët në pamundësi për t'i hedhur në kontejner i zbrazin përreth kontejnerit ku edhe bëhet ndotja e ambientit, e në këtë kontekst duhet thënë se kompania të mos i ndërprejë shërbimet por të ndërmerr ndonjë veprim vetëdijesues lidhur me inkasimin e taksës, të bashkëpunojë edhe me Drejtorinë e Inspektimeve për ti parandaluar veprimet e qytetarëve të cilët i hedhin mbeturinat e grumbulluara. Në fund ai kërkoi nga komuna që të kontrakttojë kompaninë "Uniteti" që të merr përsipër pastrimin e lumit "Tërstena" i cili fare nuk mirëmbahet, pavarësisht kostos së lartë të rregullimit të shtratit të këtij lumi.

**Zoran Rakiç, anëtar i kuvendit** - tha se kompania "Uniteti" në lokalitetet e banuara me komunitetin serb, nuk ka lidhur kontrata individuale qoftë me ekonomitë familjare apo edhe me subjekte tjera dhe kjo sigurisht se ka ndikuar në krijimin e një gjendje jo të mirë në menaxhimin e mbeturinave. Pastaj ai ceku se kjo gjendje krijon vështirësi edhe për Drejtorinë e Inspektimeve në caktimin e fletëparaqitjeve lidhur me hedhjen e mbeturinave në vendet jo adekuate, për faktin se mungojnë kushtet për vendosjen në vendin e duhur të mbeturinave. Tutja ai pyeti kryesuesin e kuvendit se a ka mundësi ligjore që kompania "Pastrimi" në Obiliq që të shtrijë operimin në fshatrat e Komunës së Vushtrrisë posaçërisht në lokalitetet e banuara nga komuniteti serb.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** – tha se kishte me qenë mirë që kompania "Uniteti" të pavarësohet nga regjioni, për faktin se në këtë formë kemi një menaxhim dhe funksionim jo të mirë për shkak se kemi disproporcion në shpërndarjen e mjeteve të inkasuara. Tutje shtoi se punëtorët e kësaj kompanie janë në një gjendje të mjerueshme për shkak se për gati tre muaj nuk marrin paga por edhe këto paga mesatarja e tyre është diku afro 200€ e cila nuk i mbulon as nevojat elementare të këtyre punëtorëve, çka në këtë situatë bie edhe motiv për punë i këtyre punëtorëve. Në fund tha se sa i përket menaxhimit të mbeturinave në komunën tonë kishte me qenë mirë që të angazhohet më seriozisht inspektorati komunal, në shqiptimin e gjobave dhe dënimeve tjera ndaj qytetarëve të pandërgjegjshëm, dhe vetëm në këtë formë do të kishim një menaxhim më të mirë dhe një mjedis më të pastër.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit** – tha se lidhur me menaxhimin e mbeturinave duhet të kemi një qasje gjithëpërfshirëse si kuvendi komunal pastaj qeveria komunale dhe kompania në fjalë dhe jo që faji dhe përgjegjësia të hidhet herë tek njëra palë e herë tek pala tjetër. Tutje shtoi se në përgjithësi duke i marrë për bazë mundësitë e kompanisë dhe problemet mendon se kompania në fjalë duhet t'i shikojë të gjitha mundësitë që nga kompania regjionale siç është tani të shndërrohet në kompani komunale. Në fund ajo shprehu si nevojë imediate hartimin e një Plani lokal të menaxhimit të mbeturinave, me qëllim që qytetin e Vushtrrisë ta nxjerrim nga kjo gjendje jo e mirë sa i përket menaxhimit të mbeturinave, ku në këtë plan do të futeshin të gjitha komponentët si vetëdijesim pastaj kushtëzim i qytetarëve, gjobat dhe çështje e tjera relevante.

**Ergyn Sunguri, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga kompania "Uniteti" që pagesat e taksave mos të bëhen me paragon – blloka, por që faturat e këtyre obligimeve të sillen në çdo shtëpi, kurse

pagesat të bëhen përmes sistemit bankar. Tutje ai shtoi se qytetarët duhet të vetëdijesohen për kryerjen e obligimeve lidhur me mbeturinat.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – tha se nuk pajtohet me konstataimin e disa prej anëtarëve të kuvendit që qytetarët nuk janë duke paguar obligimet ndaj kompanisë, kur dihet fakti se kompania “Uniteti” nuk ofron shërbime kualitative, ndaj ai bëri thirrje që qytetarët fare mos t’i kryejnë këto obligime.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se për të dal nga kjo gjendje në të cilën ndodhet kompania “Uniteti” duhet një mobilizim i përgjithshëm, andaj në këtë kontekst ceku se komuna, kompania dhe komuniteti janë tri shtylla që duhet të ndërliohen në bashkëveprim dhe vetëdijesim të përbashkët rreth zgjidhjes më të mirë të këtij problemi. Në vazhdim ai pyeti zyrtarët e kompanisë lidhur me asetet e kësaj kompanie, të cilat a janë të njëjtat që ishin dikur apo janë shtuar. Pastaj pyeti se me propozimin e ri të ligjit si do të mbetet çështja e faljes së borxheve pasi që kemi shprehje manipulative. Në vazhdim ai ceku se derisa nuk bëjmë një zgjidhje lidhur me trajtimin e mbeturinave dhe këtë nuk mund ta bëjë kompania, por duhet të angazhohemi si shoqëri dhe si vend në drejtim të trajtimit të mirëfilltë të mbeturinave, për faktin se në disa vende ku bëhet grumbullimi i mbeturinave kemi vërejtje nga organizatat e specializuara ndërkombëtare dhe lidhur me këto çështje kanë dhënë mendime negative dhe se ato duhet urgjentisht të mbyllen për shkak se të njëjtat e dëmtojnë lokalitetin aty ku janë të vendosura. Një tjetër çështje mjaft me peshë e që vlen të theksohet është çështja e kontraktimit mes kompanisë dhe qytetarëve për faktin se shërbimet nuk mund të ofrohen pa pasur një bazë kontraktuese dhe këtu duhet të kemi një angazhim të përgjithshëm. Mandej ai duke vlerësuar raportin ceku se ana teknike e tij është e hartuar mjaft mirë ku i njëjti paraqet disa elemente që ne nuk i kemi as në raportet komunale tek shpenzimet detaje. Pastaj ceku se numri i kontejnerëve të 7<sup>m3</sup> është tepër i vogël nëse e marrim që Vushtrria ka 30 Mitrovica 80, nëse e krahasojmë del se është një numër shumë i vogël që jep pak mundësi dhe nuk kemi idenë se nga duhet të koncentrohet vendosja e tyre.

**Ragip Mikushnica, menaxher i Kompanisë Unitetit** - paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me raportin në fjalë, duke parashtruar një rezymë dhe duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

#### 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi Mitrovica SH.A.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** –tha se Sa i përket Raportit vjetor të Punës së Kompanisë Rajonale “Mitrovica”, duhet thënë se sa herë që flitet për ujin neve na bie ndërmend premtimi për ujë të pijshëm për 24 orë. Në faqen 7, paragrafi 3 thuhet që ka filluar furnizimi me ujë të pijshëm prej 24 orësh që nga muaji qershor dhe kjo ceket si një e arritur shumë e madhe për qytetarët e regjionit. Shtrohet pyetja se: ku, në cilën pjesë të Vushtrrisë ka ujë 24 orë? Ta zëmë, në lagjen time në qendër të qytetit maksimumi i furnizimit me ujë është 4 deri në 5 orë në ditë, dhe besoj që edhe në pjesët e tjera të qytetit është përafërsisht gjendje e njëjtë e furnizimit, diku më keq e diku pak më mirë. Në raport po ashtu thuhet që: për dallim nga kompanitë private ku qëllimi është realizimi i profitit sa më të lartë, te kompanitë publike qëllimi është përmbushja sa më e lartë e kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve. Shtrohet pyetja se: a janë të gjithë qytetarët e barabartë para kësaj kompanie publike?, kur dihet se bëhet diskriminim i vazhdueshëm i qytetarëve vushtrrias në raport me qytetarët e Mitrovicës sa i përket orarit të furnizimit me ujë të pijshëm. Me siguri përfaqësuesit e kësaj kompanie që synim sipas tyre e kanë “përmbushjen sa më të lartë të kërkesave dhe nevojave të konsumatorëve”, nuk e panë të arsyeshme të jenë prezent në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa për të raportuar për punën e kësaj kompanie para të zgjedhurve që janë përfaqësues legjitim të qytetarëve të cilët njëkohësisht janë edhe konsumatorë. Pastaj në faqen 6, paragrafi 3, raportohet për përfundimin e impiantit për trajtimin e ujit me kapacitet prej 700 litra në sekondë pranë fabrikës ekzistuese në Mitrovicë e në të njëjtën kohë thuhet se impianti në Balincë të Vushtrrisë

me kapacitet prej 320 litrave në sekondë është para përfundimit. Pyetjet tona janë: kur, përfundimisht do të fillojë punën impianti në fshatin Balincë?, a do të zgjidhet përfundimisht çështja e furnizimit me ujë në Vushtri me hyrjen në funksion të këtij impianti? Në pronësi të kujt do të jetë ky impiant dhe pyetja e fundit është: edhe sa herë do të na thoni që impianti në fshatin Balincë është para përfundimit. Si mundet me qenë një kompani publike e suksesshme, kur e gjithë kompania sillet rreth 5-6 personave të përfshirë në të gjithë strukturën organizative të saj, si në Bord të drejtorëve, Komisionin e Auditimit të Brendshëm, Komitetin për Staf dhe Shpërblime, Komitetin për Hulumtim dhe Teknologji, Komiteti për Financa etj.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** – tha se kur bëhet fjalë për raportin për vitin 2014 të Kompanisë Rajonale Ujësjellësi “Mitrovica”, shihet se është bërë një punë bukur e madhe dhe profesionale, por në realitet mungesa e ujit në qytetin e Vushtrrisë është ende evidente megjithëse e përmirësuar kohëve të fundit sado pak. Tutje shtoi se nëpër lagjet e shumta të qytetit uji rrjedh pa ndal edhe pse kërkohet nga kompania që të evitohen këto probleme ato prapëseprapë mbeten të njëjta dhe vazhdohet me avazin e vjetër. Pastaj vlerësoi se akoma qytetarët e Vushtrrisë nëpër disa lagje ujin e pijes e përdorin në gypat e vjetruar dhe nuk janë të kyçur në sistemin e ri të ujit, kurse fshatrat nuk e kanë të ndërtuar rrjetin (infrastrukturën) e ujësjellësit. Në fund ajo pyeti zyrtarët e kompanisë se sa orë brenda 24 orëve kanë ujë Komuna e Vushtrrisë dhe sa ajo e Skënderajt.

**Faruk Hajrizi, kryeshfëf ekzekutiv i Kompanisë Ujësjellësi** - paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me raportin vjetor të kompanisë, duke parashtruar një përmbledhje të punëve, të cilat janë kryer në këtë kompani si dhe duke dhënë përgjigje në pyetje e parashtruara nga anëtarët e kuvendit.

##### 5. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2016-2018.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se është mirë që me afat dhe sipas hapave të paraparë po bëhet miratimi i KAB-it për periudhën 2016-2018. Por ceku se kemi mospërputhje të mëdha, për faktin se në këtë dokument nuk është marrë për bazë Strategjia Lokale e Zhvillimit Ekonomik 2013-2018, për të cilën kemi shpenzuar bukur një shumë të madhe të mjeteve financiare dhe fatkeqësisht nuk kemi zbatim të këtyre dokumenteve në asnjë segment ekonomik, si në punësim, shërbime publike zhvillim ekonomik dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve në përgjithësi, andaj në këtë kontekst vlerësoi se kemi diskrepancë në mes të asaj strategjie 2013-2018 dhe gjendjes reale. Prandaj në këtë rast apeloj që kur të bëhen këto dokumente mos të bëhen vetëm formalisht në letër dhe planifikimi strategjik të mos bëhet në bazë të dëshirave, por të bazohet në realitetin aktual të trendit të zhvillimit ekonomik. Mandej ai ceku se nga një dokument apo nga një raport tek tjetri sikur shfaqet një disharmoni e të dhënave për faktin se shpeshherë na del numër më i madh i popullatës, pastaj i ndërmarrjeve dhe i nxënësve, andaj kërkoi që këto tema të harmonizohen. Në vazhdim ai pyeti se pas vendimit të qeverisë qendrore për faljen e borxheve duhet ne si kuvend dhe qeveri se sa i kemi borxhe në total si ato nga tatimi në pronë, taksës në firmë, qirasë dhe format tjera të taksave dhe tatimeve të cilat i kemi të painkasume, kjo duhet të dihet për faktin se këto duhet të futen në planifikimin buxhetor për vitin vijues, për këtë ai kërkoi që t'i ofrohet një regjistër i borxhlive me qëllim që të dihet se në cilat raste po falen këto borxhe e në cilat raste jo. Në fund ai tha se të gjitha këto obligime dalin edhe nga raporti i auditorit në rubrikën e rekomandimeve, të cilat ju duhet t'i zbatoni me qëllim të hartimit të një kornize buxhetore të mirëfilltë reale dhe në përputhje të plotë me të gjitha parametrat e mundshëm të zhvillimit ekonomik të Komunës së Vushtrrisë.

**Abit Abiti, ZKF** - paraqiti sqarime të përgjithshme lidhur me procesin e hartimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2016-2018, si dhe dha përgjigje për anëtarët e kuvendit lidhur me këtë dokument komunal.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 20 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Aprovohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve Buxhetore 2016-2018 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 01/2016 të lëshuar nga Ministria e Financave, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit – tha se në këtë informatë tek paraqitja e aktiviteteve në mënyrë tabelare konkretisht tek mallrat e asgjësuar me afat të skaduar është sasia e vogël e asgjësimit prej 369.70 kg, kur dihet se tek bizneset ushqimore ka shumë mallra të skaduara dhe në tabelën e të hyrave nga mallrat e asgjësuar shuma prej 500 € është shumë e vogël. Në vazhdim ajo kërkoi nga inspektorati sanitar të ketë në konsideratë bizneset të cilat shesin gjëra ushqimore afër shkollave që të kontrollohen mallrat se a kanë afat të përdorimit me qëllim që mos të vjen deri tek helmimi i nxënësve. Në fund ajo tha se bizneset të cilat merren me përgatitjen e ushqimit (p.sh qebaptoret, gjellëtoret, furrtarët mishtoret) punëtorët e këtyre bizneseve të jenë të pajisur me uniforma, kurse konsumatorët të shërbehen me dorëza.

Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit – tha se Drejtoria Komunale për Inspektime do duhej që qëllim kryesor të punës se vet te kishte sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve të Vushtrrisë dhe punën e veprimtarinë e saj ta orientonte në drejtim të ruajtjes së një ambienti të sigurtë si nga ana higjienike-sanitare, mbrojtja e shëndetit publik përmes garantimit të cilësisë së shërbimeve dhe produkteve e deri te garantimi i një ambienti të jetesës të planifikuar dhe urbanizuar pa lejuar keqndërtime nga njerëzit e afërt me pushtetin pa asnjë kriter. Tutje shtoi se raporti përmend një numër inspektimesh dhe masash të marra nga inspektorët e kësaj drejtorie. Këto inspektime vërtetë nuk kanë asnjë lloj kuptimi derisa bëhen në mënyrë selektive duke mos i prekur subjektet e caktuara (ndotës kryesor) të qytetit dhe rrethinës që nga thertoret, të cilat funksionojnë pa asnjë kriter minimal e lëre të plotësojnë standardet HACCP. Këto thertore për me keq lirojnë ujërat e tyre të zeza të patrajtuara në sistemin e kanalizimit publik ose drejtpërdrejt në lumenjtë e qytetit, rast me eklatant është thertorja “APETIT” te Sallahanja e cila bën ndotje me përmasa të paparashikueshme në kohë dhe hapësirë! Ndotësit e tillë nuk janë të pakët në numër dhe ndotja që ata shkaktojnë janë të natyrave të ndryshme deri te ndotja akustike për të cilën kjo drejtori nuk kanë as njohuri që ekziston. Drejtoria raporton për raste të ndonjë produkti të skaduar në ndonjë raft marketesh, gjë e cila tregon se kjo drejtori funksionon me logjikën e inspektimeve të viteve 70-ta dhe me qëllim gjobitjeje për të vjelë buxhet nga qytetarët dhe bizneset e “pakrah”, përderisa do duhej që inspektimet të orientoheshin në sistemet e ngarkimit të subjekteve afariste dhe prodhuese me vetë përgjegjësi përmes personelit të kualifikuar përgjegjës për vetëkontroll dhe kjo te shtrihej në të gjithë lëmenjtë e aktiviteteve (hoteliere, ushqimore, ndërtimore, përpunuese, tregtuese dhe shërbyese).

Gëzim Saraçi, drejtor i DI-së - paraqiti sqarime lidhur me informatën në fjalë duke u përgjigjur në pyetjet e anëtarëve të kuvendit, dhe duke bërë një përmbledhje të punëve që hyjnë në domenin e kompetencave të Drejtorisë së Inspektimeve, lidhur me inspektimin e bizneseve.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë.

Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit – pyeti se çfarë është bërë me ato tetë vendimet e marra për rrënimin e objekteve pa leje dhe përse këto vendime nuk po ekzekutohen, a nuk ka vullnet që të zbatohen dhe a qëndron dikush që i pengon procedurat e zbatimit të këtyre vendimeve.



**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** – tha se ndërtimet pa leje dhe uzurpimet e hapësirave publike janë bërë dukuri e përditshme në komunën tonë, të cilat kanë prekur çdo zonë diku më shumë e diku më pak në të gjitha njësitë në territorin të komunës. Tutje ai potencoi se pronat publike janë dhënë pa kriter dhe pa meritë në lokalitetin nga vjen ai dhe kjo ka bërë që dhënia e këtyre pronave të jetë “mollë shërri atje” në vendin e quajtur “*Ura e Cakajve*”. Në fund ai pyeti se drejtorja kompetente a ka ndonjë regjistër që figuron numri i saktë i uzurpimeve të pronave publike dhe a është ndërmarr ndonjë sanksion ndaj këtyre keqbërësve.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga Drejtorja e Inspektimeve që kuvendi të ketë qasje në të gjitha aktvendimet dhe procesverbalet lidhur me ndërtimet pastaj të gjitha lejet ndërtimore (29 gjithsej) mandej të gjitha fletëparaqitjet, vendimet për rrënim për cilat objekte bëhet fjalë të gjitha këto të parashtrihen në mënyrë të detajuar.

**Gëzim Saraçi, drejtor i DI-së** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se në vitin 2015 janë nxjerr tetë aktvendime për rrënim të objekteve dhe njoftoi se tani ka filluar faza e ekzekutimit të këtyre vendimeve. Lidhur me pyetjen se për cilët titullar të objekteve të rrënuara bëhet fjalë, vlerësoi se kjo nuk është relevante porse relevante në këtë rast është se ato leje janë lëshuar konform kritereve urbanistike. Pastaj fletëparaqitje janë ushtruar ndaj gjithë atyre të cilët nuk e kanë respektuar urdhrin për ndërprerje të punimeve. Në fund ai njoftoi se objektet e rrënuara, të cilat kanë paraqitur rrezik dhe ndotje të ambientit, për këtë kryetari i komunës ka formuar një komision i cili ka bërë vlerësime lidhur me rrezikun e këtyre objekteve dhe se shumica e këtyre objekteve kanë paraqitur rrezik dhe ndotje të ambientit dhe të njëjtat kanë qenë prona të braktisura. Në fund ai tha se nëse do të futen në informatë të gjithë ata emra që lidhen me fushën e ndërtimit, atëherë kjo informatë do të dilte tepër voluminoze, por nëse një gjë e tillë kërkohet atëherë drejtorja do ta sjell një version të tillë të kësaj informate.

## 8. Të ndryshme.

**8.a).** Shqyrtimi i kërkesës së fshatrave Lumadh dhe Stanoc i Epërm lidhur me trasenë e rrugës Vushtri-Prishtinë.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** - duke iu referuar takimeve me banorët e fshatit Lumadh dhe Stanoc i Epërm, të cilët janë të shqetësuar për faktin se nuk merren parasysh kërkesat nga institucionet komunale, e aq më pak Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kërkesë kjo që ka të bëjë me ndërtimin e rrugës magjistrale Vushtri-Prishtinë. Këta banorë i janë drejtuar disa herë edhe kryetarit të komunës e që sipas tyre nuk kanë marrë përgjigje adekuate, madje as përkrahje. Përderisa drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, z. Sami Istrefi, i kishte ftuar ata në takim, por që nuk i kishte pritur, ndërsa ne si kuvend propozoj që mos ta bëjmë të njëjtën gjë. Pastaj ajo vlerësoi se kuvendi duhet ta trajtojë drejt çështjen e 750 nënshkrimeve të këtyre dy fshatrave dhe të angazhohemi në gjetjen e zgjidhjes sa më të shpejtë të këtij problemi. Banorët kërkojnë që hyrja dhe dalja e fshatit Lumadh dhe Stanoc i Epërm të jetë nën urën unazore, ashtu siç ishte në projektin fillestar, por që sipas tyre me ndryshimin e këtij projekti rruga jo vetëm që ka devijuar, por edhe ka pësuar ndryshime të mëdha në vendosjen e stacionit të autobusëve, nënkalimit, etj. Banorët pretendojnë se këtu ekziston ndonjë parregullsi që komuna ose ministria tentojnë t’ua fshehin, madje ata përmendin edhe dhënie në shfrytëzim të pronës komunale e cila i është dhënë z. Musa Cakaj. Ndërsa, sa i përket nënkalimit dhe stacionit të autobusëve, kërkohet që nënkalimi të vendoset afër udhëkryqit tek “Përroi i Cakajve”, siç e quajnë ata, dhe ku aty është vendi i përshtatshëm për kalim të sigurt për banorët e sidomos fëmijët, sepse aty gjendet edhe shkolla. Stacioni i autobusëve të jetë në vendin ekzistues, i cili është ndërtuar në vitin 1963, aty ku gjendet edhe sot. Andaj pavarësisht faktit që kjo është kompetencë e ministrisë, ne si anëtarë të këtij kuvendi, e kemi obligim t’i shqyrtojmë kërkesat e qytetarëve dhe t’i përkrahim deri aty ku nuk

e shkelim ligjin, që do të thotë se në këtë rast ne kemi të drejtë të kërkojmë nga Ministria përkatëse që t'i respektojë kërkesat e këtyre banorëve dhe të na jap sqarime lidhur me pretendimin e banorëve se ky projekt është ndryshuar. Në fund ajo tha se nëse është e nevojshme, kuvendi ka mundësi që të formojë një komision në mënyrë që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejt që është e mundur, sepse ka një kohë të gjatë që këta banorë nuk gjejnë përkrahje as në komunë dhe as në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – propozoi që të formohet një komisioni cili do të merret me adresimin dhe zhvillimin e takimit me zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës lidhur me verifikimin e gjendjes së trasesë së rrugës Vushtrri- Prishtinë. Tutje ai duke iu referuar një takimi mes banorëve dhe ministrit Zharku citoi se i njëjti ka fajësuar komunën rreth problemeve lidhur me këtë rrugë. Andaj vlerësoi se nëse nuk ndërmerren veprime të shpejta ne mund të përballemi me situata të pakëndshme nga ana e banorëve të këtyre fshatrave.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** – tha se problemi kryesor në këtë çështje është fakti se tri familjeve iu janë dhënë në shfrytëzim prona publike nga ana e komunës dhe interesat e tyre gërshetohen në këtë fakt, andaj pikërisht dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave është bërë mollë sherri për këqjen dhe shkyçjen nga traseja e rrugës.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – tha se defekti kryesor është se komuna e ka dhënë në shfrytëzim prona pa kriter dhe për këtë dikush duhet të jap përgjegjësi para organeve kompetente, andaj propozoi që të formohet komisioni për verifikimin e gjendje së kësaj rruge.

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke i propozuar kuvendit që të formojë komisionin në fjalë për verifikimin e gjendjes së rrugës Vushtrri-Prishtinë.

**Argon Përçuku, anëtar i kuvendit** - propozoi për anëtar të komisionit Agim Bregajn.

**Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit** – në emër të grupit kuvendar të VV-së propozoi për anëtar të komisionit Mehmet Selacin.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – propozoi Isa Hajrizin për anëtar të komisionit.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për verifikimin e gjendjes së trasesë së rrugës Vushtrri-Prishtinë, pas ankesave të fshatrave Lumadh dhe Stanoc i Epërm, në këtë përbërje:

1.1 Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit (PDK)

1.2 Agim Bregaj, anëtar i kuvendit (LDK)

1.3 Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit (VV)

2. Komisioni në fjalë duhet të merret me verifikimin e gjendjes faktike të trasesë së rrugës Vushtrri-Prishtinë dhe pas verifikimit çështjen do ta adresojë në ministrinë përkatëse.

8. b). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Fatime Haziri, anëtare e kuvendit** – tha se një grup i qytetarëve të komunës sonë ka kërkuar që komuna t'u mbulojë shpenzimet e varrimit, ajo një kërkesë të tillë e arsyetoi me faktin se një gjë të tillë e kanë realizuar shumë komuna të Kosovës, dhe mirë kishte me qenë që edhe komuna jonë të sigurojë shpenzimet e tilla, në të kundërte ajo njoftoi se një grup i qytetarëve do t'i drejtohet kuvendit me një peticion.

**Syzana Sylja, anëtare e kuvendit** – kërkoj nga DSHP-ja dhe policia që të bëjë eliminimin e parregullsive në qytet, ndërsa ajo konkretisht ceku se rruga nga komuna deri tek Shtëpia e

mallrave është mjaft e ngarkuar nga automjetet të cilat parkohen, kurse shenja është vetëm për ndalim, propozoi që të vendoset shenja mosndalim dhe parkim. Pastaj kërkoi që kjo rrugë të riparohet pasi që është mjaft e dëmtuar, kurse rruga tek kopshti i fëmijëve është e ngushtë dhe në të dy anët e rrugës parkohen vetura përgjatë kësaj rruge, dhe në këtë formë po rrezikohen fëmijët. Ajo me këtë kërkoi që edhe në këtë rrugë të vendoset shenja e mosparkimit. Në vazhdim ajo ceku se lumi "Tërstena" është në një gjendje të mjerueshme ku nga të reshurat janë dëmtuar kubëzat, janë dëmtuar rrethojat, si dhe mund të thuhet se lumi është vërshuar nga mbeturinat, kurse punëtorët e angazhuar për pastrim me kontratë mbi veprën nuk shihet se kanë bërë ndonjë veprim, kurse ne të gjithë e dimë se sa ka qenë kostoja e ndërtimit të shtratit të këtij lumi.

**Selvete Sholla, anëtare e kuvendit** – paraqiti shqetësimin e banorëve të lagjes "Hamdi Gashi" e sidomos të banorëve afër lumit "Podranqë" ku bëhet lidhja e shëtitores "2". Këta banorë janë të rrezikuar nga ujërat e zeza e sidomos problem paraqet shembja e urës së vjetër, andaj kërkoi që të ndërmerren masa të menjëhershme nga organet kompetente për heqjen e këtyre mbeturinave, si dhe të mos bëhet pranimi teknik i shëtitores pa u bërë rregullimi ashtu qysh kërkohet në projekt. Pastaj në fotografitë e prezantuara njoftohet se drunjat dekorativ të cilët janë mbjellë ditë më parë asnjë nuk ka përparuar. Mandej heqja e pengesës dhe kalimi i traktorëve nëpër shëtitore, pastaj ujërat e zeza afër tregut. Në fund ajo pyeti komisionin për emërimin e rrugëve se në rr. "Hamdi Gashi" ku lidhet një rrugë më e shkurtër me emrin "Rushit Stroci" kurse për të njëjtën por me dy tabela figuron emri "Rrushit Strofc" kërkoi që kjo çështje të përcaktohet saktë.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga Drejtoria e Inspektimeve që për mbledhjen e ardhshme të na sjellë informatë me shkrim lidhur me tetë vendimet e nxjerra në vitin 2014 për rrënim, për cilat prona dhe për cilët titullarë bëhet fjalë dhe përse këto objekte nuk janë rrënuar deri me sot.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:18.**


**Bastri Duraku**



**Procesmbajtës**

**Lekturoi**

**Vlora Krasniqi**



**Shpëtim Zhegrova**

**Kryesues i Kuvendit**